

HOLZ KITT



PËRSHKRIMI

Stuko akrilike për riparimin e drurit, me bazë uji

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

- Gjendet në 17 ngjyra
- Ngjitje e fortë dhe pa tkurrje
- Nuk e njollos sipërfaqen e drurit
- Thahet shpejt dhe i reziston lagështisë
- Krijon një sipërfaqe të fortë, të durueshme dhe të lëmuar

PËRDORIME TË REKOMANDUARA

E përshtatshme për mbushjen dhe mbulimin e defekteve në shtresën sipërfaqësore. Mbyll hapësirat dhe fugat në dyshemetë prej melanine dhe druri, sipërfaqet e llakuara, kompensatë dhe Formica, MDF etj. I shkëlqyer për ripaime në mobilje druri, dyer druri dhe panele tavanesh.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Rezina	Kopolimer Akrilik
Densiteti	1,15±0,02 gr/ml
EN ISO 2811-1	1,05±0,02 gr/ml
Mbetja e thatë	100 – 300%
EN ISO 3251	70%
Shkalla e hollimit	Gati për përdorim
Ngjyra	17 ngjyra natyrale
Forca ngjitëse ne beton	≥ 0,8 N/mm2
Konsumi	1kg/m2
Koha e tharjes mes dy shtresave	2 – 4 minuta
në varësi të kushteve të ambientit. Shtresa e parë duhet të jetë e thatë plotësisht para aplikimit të shtresës së dytë	
Koha e tharjes për zmerilim	24 orë
Rezistenca në perkulje	≥ 400 N

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqja duhet të jetë e zmeriluar dhe pastruar me ajër në mënyrë që të realizohet ngjitja e mirë e produktit..

PERGATITJA E PRODUKTIT

Fillimisht bëni perzjerjen e produktit duke e homogjenizuar.

APLIKIMI

Aplikimi i produktit Holz Klitt bëhet me spatul. Fillimisht produkti hapet mbi sipërfaqen e drurit duke mbushur të gjitha gropizat ose të carat. Aplikimi bëhet duke aplikuar një ose dy shtresa në varesi të plasartjes ose të carave në mënyrë që të bëhet mbushja sa më e mirë e sipërfaqes së drurit. Pastroni mjetet e punës menjëherë pas përdorimit duke përdorur ujë të rrjedhshëm.

RUAJTJA DHE JETËGJATËSIA

36 muaj, në qoftë se ruhet në paketim të mbyllur dhe në kushte normale.

SHËNIME

Rekomandohet që të shmangët aplikimi i produktit në temperatura nën 5°C.

PAKETIMI

Kova plastike 0.2Kg

INFORMACIONI MBI SHËNDETIN, SIGURINË DHE MJEDISIN

Mbajeni larg fëmijëve produktin. Nëqoftëse gëlltitet lajmëroni dhe kërkoni ndihmën e mjekut dhe tregojini atij përmbajtjen e ambalazhit. Mos e hidhni produktin në tubacione ose kanale.

